

U D H Ë Z U E S

Për zbatimin e kriterëve nga ana e komisionit intervistues për punësimin e kuadrove në vendet e punës për mësimdhënës të Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese në Komunën e Gjilanit

Procesverbalet – formularët përbëhen prej 2 (dy) pjesëve

1 . Pjesa e parë e procesverbalit

1.1 Në këtë pjesë të procesverbalit, kandidati poentohet në bazë të dokumentacionit të tij.

1.2. Kjo pjesë e procesverbalit plotësohet vetëm nga kryetari i komisionit intervistues.

1.3 Pjesa e procesverbalit që ka të bëjë me përvojën e punës relevante në arsim si mësimdhënës dhe pritja për punësim në institucionet arsimore, kandidati vlerësohet vetëm në njërin e cila është më e favorshme për kandidatin.

1.4 Pjesa që ka të bëjë me përgatitjen profesionale - kualifikimin, kandidati poentohet duke u mbështetur në normativet e MASHT-it në fuqi. p.sh 12 pikë për kualifikim Master, poentohet kandidati në qoftëse normativet në fuqi parashohin kualifikimin Master për ato lëndë mësimore.

1.5 Pjesa që ka të bëjë me licencën për mësimdhënie : kandidati i cili posedon licencën për mësimdhënie e lëshuar nga MASHT-i, poentohet me 1 pikë, ndërsa kandidati që nuk posedon licencën, por posedon vërtetimin se ka aplikuar për licencë, poentohet me 0.50 pikë.

2. Pjesa e dytë e procesverbalit

2.1 Kjo pjesë e procesverbalit plotësohet nga secili anëtar i komisionit individualisht (tre anëtarët e komisionit).

2.2 Secili anëtar i komisionit e poenton kandidatin sipas vlerësimit të tij, minimumi i pikëve është 1 dhe maksimumi 2 pikë.

Rezultati për kandidatin e suksesshëm

Pikët e grumbulluara nga pjesa e procesverbalit të parë dhe pikët e grumbulluara nga pjesa e procesverbalit të dytë duke i llogaritur pikët e tre anëtarëve të komisionit mblidhen dhe rezultojnë totalin e pikëve të fituara.

Kandidati i cili grumbullon më së shumti pikë është fitues i vendit të punës.

Regjistri përfundimtar i kandidatëve sipas pikëve të fituara , duhet të jetë i nënshkruar nga tre anëtarët e komisionit intervistues.

Procesverbal i të intervistuarve
Formulari për nivelet e Institucioneve : Parafillor, Fillor dhe të Mesëm të Lartë

Pjesa e –I-
Sqarim : ky procesverbal plotësohet vetëm nga kryetari i komisionit intervistues

Emri dhe mbiemri i kandidatit _____. Shkolla _____

Kriteret	Pikët
<u>Kualifikimi :</u> Master = 12 Fakulteti - 4 vjeçar (240 ETCS) = 10 Fakulteti - 3 vjeçar (180 ETCS) = 8	12 10 8
<u>Përvoja e punës në arsim si mësimdhënës</u> Deri në 5 vite, 0.2 pikë për një vit	_____
<u>Pritja për punësim në Institucionet e Arsimit</u> Deri në 5 vite, 0.2 pikë për një vit	_____
<u>Nota mesatare gjatë studimeve poentohehet :</u> 6 deri 6.5 – 0.1 6.51 deri 7 -- 0.2 7.01 deri 7.5 – 0.3 7.51 deri 8 – 0.4 8.01 deri 8.5 – 0.5 8.51 deri 9 – 0.6 9.01 deri 9.5 -- 0.7 9.51 deri 10 – 0.8	_____
<u>Licenca për mësimdhënie e lëshuar nga MASHT = 1</u>	_____
<u>Vërtetimi se ka aplikuar për licencë = 0.50</u>	_____
<u>Kandidati vendas</u> kandidati që jeton në lokalitetin ku gjendet shkolla, 0.50 pikë (ky kriter vlen vetëm për shkollat fillore të mesme të ulëta në fshatra)	_____
<u>Kandidati banor i Komunës së Gjiçanit, 050 pikë</u>	
Gjithsej pikë :	

Emri dhe mbiemri i kryetarit të komisionit intervistues _____

Nënshkrimi _____

Data e intervistimit _____

Komente eventuale

Procesverbal i të intervistuarve
Formulari për nivelet e Institucioneve : Parafillor, Fillor dhe të Mesëm të Lartë

Pjesa e –II—

Sqarim : kjo pjesë e procesverbalit plotësohet nga secili anëtar i komisionit intervistues individualisht.

Emri dhe mbiemri i kandidatit _____. Institucioni _____

Kriteret	Vlerësimet Pikët
<u>Shkathtësitë në interpretim profesional</u> 1 pikë, 1.5 pikë, 2 pikë	_____
Sqarim : Në rast se nuk ka kandidatë të kualifikuar sipas normativet në fuqi, komisioni intervistues do të bëjë një emërim të përkohshëm konform nenit 35 parag 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, nr.04/L-032, nga radha e kandidatëve me drejtim dhe kushte më të përafërta.	

Emri dhe mbiemri i anëtarit të komisionit intervistues _____

Nënshkrimi i anëtarit të komisionit intervistues _____

Data e intervistimit _____

Komente eventuale :[illegible]

